



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KZAZ-VE NR. 07, NR. 60, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 26.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr. 07, nr. 60, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 21, pika 11, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- me shkresën nr. 4658 prot., datë 24.05.2019, lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.60, Qarku Fier.
- me shkresën nr. 4659 prot., datë 24.05.2019, lirim dhe emërim e anëtarit të KZAZ nr.07, Qarku Shkodër.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesat dhe propozimet e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.



Nr. 652 i Vendimit Data 26.05.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr. 07, nr. 60,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 11, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ-së nr.7, zj. Denisa Isa Islami, Bashkia Pukë, dhe anëtarin e KZAZ-së nr. 60, z. Maksim Miço Goga, Bashkia Roskovec.
2. Të emërojë anëtarin e KZAZ-së nr.7, zj. Besiana Skënder Kuçi, Bashkia Pukë, dhe anëtarin e KZAZ nr. 60, z. Emiljan Qamil Kuka, Bashkia Roskovec.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

